

## TERMAT NË LIDHJE ME STRUKTURËN SEMANTIKE TË FJALËS NË SHQIPE NË PËRQASJE ME GREQISHTEN

**Prof. Asoc. Dr. Eda Shehu**

Departamenti i Gjuhëve Sllave e Ballkanike  
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës  
E-mail: eda.shehu@unitir.edu.al

### PËRMBLEDHJA

Në studimet rreth leksikut të çdo gjuhe vend të veçantë zënë marrëdhëniet e fjalëve dhe termave, sidomos, vështrimi i termave të ngritur mbi bazën e fjalëve të zakonshme nga ku mund të krahasohen struktura semantike e fjalës me strukturën konceptore të termit. Përqasja e dukurive që vihen re në këtë vështrim me një gjuhë të huaj hedh dritë dhe çon më tej studimin në të dyja gjuhët rreth kësaj shtrese të leksikut. Këtu, në këtë studim trajtohen termat njëfjalësh të ndërtuar mbi bazën e kuptimit të fjalëve të zakonshme dhe zhvillimin e tyre në terma togfjalëshash në shqipe dhe në greqishte, nga ku vërehen mjaft dukuri interesante në anë të përbashkëta e të veçanta në secilën gjuhë, siç mund të sillen si shembuj në shqipe: rrënjë (fjalë e zakonshme) → rrënjë (term në matematikë) dhe më tej: rrënjë katrore, rrënjë kubike dhe përkatësisht në greqishte: τετραγωνική ρίζα, ρίζα κύβου.

Fjalët çelës: leksik, gjuhë, strukturë konceptuale, strukturë semantike, terma.

### ABSTRACT

In the study about the lexicon of each language a special place is occupied by the relations of words and terms, especially, the look of terms raised on the basis of ordinary words from where the semantic structure of the word can be compared with the conceptual structure of the term. The approach of the phenomena observed in this view with a foreign language sheds light and leads further the study in both languages about this layer of lexicon. Here, in this study, are treated the one-word terms built on the basis of the meaning of common words and their development into phrase terms in Albanian and Greek, from where many interesting phenomena are observed in common and specific aspects in each language, as can be brought as examples in Albanian: rrënjë (common word) → rrënjë (term in mathematics) and further rrënjë katrore, rrënjë kubike and respectively in Greek: τετραγωνική ρίζα, ρίζα κύβου.

Keywords: lexicon, terms, conceptual structure, semantic structure, language.

Fjalët dhe termat në studimet rreth leksikut në çdo gjuhë, sikurse në shqipe dhe në greqishte, janë pranuar si njësi emërtuese të ndryshme, me tipare të dallueshme, që veçohen në fondin tërësor të leksikut si pjesë e mëvetësuar e tij, ndonëse kanë edhe anë të përbashkëta, si edhe raste kalimesh nga njëra njësi tek tjetra<sup>1</sup>. Duke nxjerrë në pah fjalët dhe termat, si dy shtresa njësisht që kundërvihen brenda leksikut tërësor të gjuhës e që përbëjnë kështu të dyja së bashku fondin leksikor të gjuhës, prof. A.Kostallari<sup>2</sup> i ndan njësitë leksikore të gjuhës në joterma dhe terma, duke i diferencuar si pjesë të mëvetësuar. Duke i vështuar këto dy kategori leksikore në lidhje me njëra-tjetrën, mund të pohohet, se fjalët (jotermat), janë parësore ndaj termave, kështu që, këto të fundit, dalin në funksionin e tyre në gjuhë, si dytësore dhe si bazë për formimin e tyre janë fjalët, (këtu kihet parasysh këtu fjalët e zakonshme.) Megjithatë një pjesë termash, mund të konsiderohen si njësi të mirëfillta terminologjike (terma), nga ku zbulohet vetëm përkatësia e tyre në një fushë dije, si në shqipe, ashtu edhe në greqishte, si p.sh.: tretësirë (kim.) / (το διάλυμα) (greq.), trekëndësh (mat.) / ( το τρίγωνο) (greq.), diferencial (το διαφορικό) (greq.). Kryesisht, pjesa tjetër vjen nga fjalët (e zakonshme), ku fjalët ngrihen në terma, kur përdoren në ligjërimin e një fushe të veçantë dije ose kur përdoren dhe si fjalë dhe si terma, si p.sh.: nga vesh (njeriu) (fjalë e zakonshme dhe term) (në mjekësi) → vesh (plugu) (term) (në bujqësi) dhe pikërisht në greqishte αντί (άντρας) (fjalë e zakonshme dhe term), αντί (άποτρο) (term) (në bujqësi). Megjithatë, nga ana e formimit të tyre në çdo gjuhë, fjalët dhe termat kanë rrugë të afërta a të përbashkëta, por ka raste kur ato ndërtohen në mënyra origjinale, sidomos termat që ngrihen, si të tilla, mbi bazën e fjalëve të zakonshme, sikurse sollën më sipër vesh si fjalë dhe si term. Fjalët dhe termat jepen si gjegjëse barazvlerëse, kur ballafaqohen në rrafshë ndërgjuhësore, ku ato ruajnë në të dyja gjuhët (ose në të gjitha gjuhët që përqasen) individualitetin e tyre.

Konceptimi i fjalëve dhe i termave si një fond i përbashkët leksikor, por me anë të përbashkëta dhe të kundërta, me lidhje të brendshme e kalime të njësisve njëra tek tjetra, jep mundësinë të vështrohen edhe lidhjet e kuptimeve përkatëse të tyre brenda strukturave kuptimore të secilës njësi<sup>3</sup>. Kështu brenda strukturave kuptimore të fjalëve nxirren edhe lidhjet e tyre me kuptimet e termave<sup>4</sup>, kur një njësi me strukturat e saj del edhe si fjalë edhe si term, e shprehur nga e njëjta shenjë, si në shqipe, ashtu edhe në greqishte: rrënjë1 (fjalë) - rrënjë2 (term) / (gr.) η ρίζα1 (fjalë) - η ρίζα2 (term), (shq.) kokë1 (fjalë) - kokë2 (term) / (gr.) το κεφάλι1 (fjalë) - το κεφάλι2 (term), pikë1 (fjalë) - pikë2 (term) / (gr.) η τελεια1 (fjalë) - τα στυματα2 (term).

1 A.Duro, *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009.

2 A. Kostallari, *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë*, Sf., Nr.4, f.42. Tiranë, 1984.

3 E. Lafe, A.Çepani, *Rreth pasqyrimin të fushave terminologjike në "Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe"* në *Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektive*, Tiranë, 2004.

4 Th. Feka, *Vëzhgime mbi leksikun terminologjik në "Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe"*, "Studime filologjike", 1986/2.

Secili term i mësipërm, si rrënjë2 - kokë2 - pikë2 krijon lidhje brenda të njëjtës shenjë, duke shprehur koncepte të fushave të ndryshme, si rrënjë1 (bot.) - rrënjë2 (dhëmbi) (mjek.) - rrënjë3 (katrore) (mat.) etj., të cilat në terminologjitë dalin si homonime. Si njësi barazvlerëse terminologjike në greqishte kemi: η ριζα1 (bot.) - η ριζα2 (δοντιων) (mjek.) - τετραγωνικη ριζα3 (mat.)

Nga paraqitja e mësipërme del se, lidhjet e brendshme të strukturave kuptimore të termave në nivel homonimesh (rrënjë1(bot.) - rrënjë2 (mjek.) - rrënjë3 (mat.), që u dalin nga struktura kuptimore e fjalës (në rastin tonë rrënjë / (gr.) η ριζα1 (fjalë), - η ριζα2 (mjek.) - η ριζα3 (mat.), pasqyrohen në strukturat semantike të fjalëve në fjalorët dygjuhësh të gjuhës së përgjithshme në gjuhën dhënëse dhe marrëse si gjegjëse barazvlerëse leksiko-semantikë, si, p.sh. në shqipe rrënjë1 (fjalë) - rrënjë2 (term) - rrënjë3 (term) dhe përkatësisht në greqishte: η ριζα1 (fjalë) - η ριζα2 (term) - η ριζα3 (term) siç e përmendëm dhe më sipër. Ky proces ka vlera teorike e praktike, meqë mbështetet mbi një lëndë shumë të gjerë leksikografike. Megjithatë në këtë trajtesë ne mbështetemi në dy fjalorë dygjuhësorë: shqip - greqisht<sup>5</sup> / greqisht-shqip (për fjalët dhe termat)<sup>6</sup>.

### 1. Përmbajtja e strukturave semantike të fjalëve dhe ballafaqimi i tyre në shqipe dhe në greqishte

Kur vështojmë fjalët e një gjuhë në përgjithësi (p.sh. të gjuhës shqipe) në ballafaqim me një gjuhë tjetër (me greqishten ose me disa gjuhë njëkohësisht), sidomos në fjalorët dygjuhësh (në rastin tonë shqip-greqisht dhe greqisht-shqip), realisht konstatohen se ato pasqyrohen të kundërvëna në strukturat semantike të tyre. Në paraqitjen ballafaqese të strukturave kuptimore të fjalëve ne zbulojmë për secilin kuptim të veçantë a ngjyresë kuptimore të tyre në njëren gjuhë, barasvlerësit kuptimorë në gjuhën tjetër, të shfaqura si barasvlerës shenjorë-kuptimorë. Kështu, p.sh., kuptimet e fjalës shqipe pikë jepen të zbërthyera në një varg barasvlerësish shenjoro-kuptimorë në gjuhën greke që pasqyrohen në strukturën semantike të tyre, si: pikë (shq.) / (gr.): 1. η σταγόνα, η σταλα, 2. τα στιγματα, 3. η αποπληξια, 4. η τελεια, 5. κατευθυνση, 6. το σημειο, το οριο, 8. ποντος, etj. Këtu futen edhe kuptime të tjera të fjalës shqipe pikë, të pasqyruara në barasvlerës kuptimorë në gjuhën greke, kryesisht të nivelit të figurshëm, si: ακριβως, νταμπλας, καταρα etj.

Mund të theksohet se, në mënyrë ballafaqese, çdo barasvlerës shenjor-kuptimor në gjuhën e huaj (greke) jepet vetëm në një kuptim të tij, si p.sh. pikë në raport me η σταλα të (kupt. 2), në lidhje me η τελεια të (kupt. 5), në lidhje me το σημειο (kupt. 6), po pikë në raport me η σταλα, ακριβως, νταμπλας, καταρα, etj., meqë në vetvete, secili barasvlerës,

5 N.Gjini, *Fjalor shqip-greqisht*, Janinë, 1998.

6 N.Gjini, *Fjalor greqisht - shqip*, Janinë, 1993.

si fjalë më vete në greqishte (si η σταγονα, η σταλα, τα σιγματα, η αποπληξια, η τελεια, το σιμειο,) ka strukturën e vetë kuptimore me barasvlerësit përkatës. Kështu, pikë e greqishtes ka si barasvlerës: pikë; njollë; vrimë; shenjë; vend etj. në shqipen. Nga ana e vet, edhe fjala pikë në shqipe, e marrë në vetvete, bashkëlidhet me fjalë të tjera shqipe, mbi bazën e kuptimeve të tyre të njëjta me fjalën pikë, në çdo kuptim të saj, si: pikë: 1.grimcë; 2. qendër; 3. njollë e vogël; 6. shenjë pikësimi; 7. vend referimi; 9. drejtim; 10. kufi; etj. / (në greqisht) Υ σταγονα (Αλβανο-Ελληνικο Λεξικο) 1.η σταγονα, 3.το σιγμα, 6.η τελεια, 6.το σιμειο, 7.το σιμειο, 7.το σιγμα 10.το σιμειο, 11.η αποπληξια,

Pra, në rrafshin e kuptimeve leksikore sistemet leksikore nuk përputhen ndërmjet gjuhëve. Ato mund të jenë të ngjashme, të afërta ose edhe të ndryshme dhe, si të tilla, paraqiten në forma shumë komplekse.

Ballafaqimi i strukturave kuptimore të dy gjuhëve dëshmon se marrëdhëniet e ndërmjet barazvlerësve shenjoro-kuptimore mund të krijojnë lidhje të caktuara, të ngjashme me lidhjet sinonimike të një gjuhe të veçantë. Në këtë rast mund të flitet për sinoniminë ndërgjuhësore, ndërmjet së cilës mund të studiohen marrëdhëniet kuptimoro-leksikore ndërmjet gjuhëve në bazë të përqasjes së strukturave semantike të fjalëve.

Megjithatë, karakteri (natyra) e lidhjeve ndërmjet kuptimeve mund të jenë të formave të ndryshme. Ato mund të jenë të drejtpërdrejta, por ato mund të jenë të zhdrejta, duke u shmangur nga kuptimet themelore. Këto kalime kuptimesh ndonjëherë brenda një fjale në një gjuhë të dhënë mund të jenë të tilla, që lidhjet ndërmjet kuptimeve bëhen shumë të kapshme, sidomos kur dalin nga një bazë e përbashkët, si edhe kur dalin njëri nga tjetra, por ato mund të jenë më të largëta deri sa mezi ndahen si të tilla, duke përfunduar në homonime.

Duke i modeluar lidhjet kuptimore në struktura semantike të fjalëve mund të përcaktojmë këto tipologji rastesh:

- a) lidhjet me kalime të drejtpërdrejta: pikë1 në shqipe / (greqishte)- η τελεια
- b) lidhjet me kalime të zhdrejta: pikë2 në shqipe (njollë, shenjë) / (në greqishte) - τα σιγματα
- c) lidhjet me kalime komplekse (kur kombinohen lidhjet e drejta me të zhdrejtë): pikë3 - / (greqisht) ακριβως i rëntë pika (sëmundje) - νταμπλας (καταρα).

Kjo do të thotë se, sa më komplekse të jenë lidhjet ndërmjet kuptimeve brenda një gjuhe, të zbuluara në strukturat kuptimore të fjalëve, aq më e vështirë bëhet gjetja e barasvlerësve shenjoro-kuptimorë në gjuhën tjetër që përqaset me të. Për këtë arsye në shumë raste vetëm konteksti mund t'i zgjidhë gjetjen e barasvlerësit përkatës në gjuhën tjetër, ku kompleksiteti i lidhjes kuptimore është shumë i madh. Në këtë rast sa më e gjerë të jetë struktura kuptimore e fjalëve, aq me vështirë gjenden barasvlerësit në gjuhën që ballafaqohet, siç del nga fjala me strukturë të gjërë kuptimore, si tek foljet: bëj, marr, jap; tek emrat: rrugë, bukë etj.

## 2. Paraqitja e termave në lidhje me strukturën semantike të fjalëve

Ndërmjet fjalës (së zakonshme) dhe fjalës së ngritur në term (fjalës term), nga njëra anë, si edhe kuptimeve terminologjike, në strukturën semantike të fjalës dhe kuptimeve të tjera të saj, nga ana tjetër, krijohen marrëdhënie të ndryshme, të cilat kushtëzohen nga natyra jo e njëjtë e këtyre kuptimeve dhe e njërive leksikore që i shënojnë ato. Kështu, një pjesë kuptimesh kanë një karakter të drejtpërdrejtë special terminologjik, të qartë e të kristalizuar, secili nga të cilët ka në fushën përkatëse të dijes fjalën term si shënues të pavarur, si, p.sh. kuptim terminologjik “*pikë*” (gjeom.) / (gr.) το σημείο dhe termi *pikë*, kuptimi “*rrënjë*” (mat.) / (greqisht) η ρίζα dhe termi *rrënjë* (gr.) η ρίζα. Tek disa të tjera ky kuptim terminologjik nuk mëvetësohet si i tillë, por zbulohet si kuptim i përgjithshëm special në lidhjet leksiko-sintaksore, në të cilat hyn fjala si fjalë e zakonshme me fjalët e tjera si p.sh. kuptimi special “cak deri ku arrin të zhvillohet një proces i fjalës *pikë* në lidhjet leksiko-sintaksore që hërbejnë si terma *pikë shkrirje*, *pikë ngrirje*, *pikë vlimi*, *pikë vese* (term) / (greq.) σημείο τήξης, σημείο πήξης, σημείο βρασμού, σημείο δρόσου. Disa kuptime terminologjike mund të zbulohen edhe brenda lidhjeve leksiko-sintaksore që përdoren në strukturën semantike të fjalës së lëndë ilustruese, si p.sh. *shpim mekanik*, *shpim elektrik* (= “*shpim*”), “*shpim*” (elektik) / (greq.) μηχανική διάτρηση, ηλεκτρική διάτρηση (= “*διάτρηση*”), “*διάτρηση*” (ηλεκτρική) d.m.th. kuptimi terminologjik “*shpim*” në mek,” si proces përpunimi me prerje për hapjen e vrimave ...”); *lodhje fizike* / (greq.) σωματική κόπωση ( d.m.th kuptimet terminologjike “*lodhje*” në mek, dhe fiziol / (greq.) “*κούραση*”; *goditje në krahë* = “*goditje*” në usht.) / (greq.) χτύπημα στα φτερά etj.

Një pjesë kuptimesh terminologjike nuk pasqyrohen si të tilla në strukturën semantike të fjalës, por ato përmbahen pjesërisht në njërin nga kuptimet e saj. Ky kuptim “shndërrohet”, ngrihet në kuptim terminologjik me elementet e veta plotësuese semantike në një fushë të caktuar të dijes. Kështu p.sh. mund të sjellim si shembull kuptimet e fjalëve shqipe: *rrënjë*, *lumë*, *kokë*, si kuptime të zakonshme dhe kuptimet terminologjike po të këtyre fjalëve terma në fusha të ndryshme si *rrënjë* (bot.), *mal*, *lumë* (gjeogr.), *kokë* (anat.) etj. në forma barzvlërëse në greqishte: η ρίζα (bot.), το βουνό, το ποτάμι (gjeogr.), το κεφάλι (anat.).

Duke e vështuar strukturën semantike të fjalës nga pikëpamja e rrafshit të fjalës term mund ta përfytyrojmë këtë të fundit si një strukturë të gjerë semantike speciale, brenda së cilës në rastin më të mundshëm mund të zbulohen katër lloje kuptimesh<sup>7</sup> me veçori specifike për secilin prej tyre<sup>8</sup>: 1) kuptime speciale terminologjiksht të kristalizuara, të veçueshme si kuptime të mirëfillta brenda strukturës semantike të fjalës: 2) kuptime speciale terminologjiksht të pakristalizuara: 3) kuptime speciale të dyzuara, brenda të cilave bashkëtojnë në simbiozë kuptimi i zakonshëm i fjalës me kuptimin terminologjik:

7 S.Kurti, *Fjalor politeknik anglisht-shqip*, Tiranë, 1991.

8 S.Kurti, *Fjalor politeknik rusisht-shqip*, Tiranë, 1981.

4) kuptime terminologjike të zbuluara në lidhjet leksiko-sintaksore të fjalës, të përdorura si lëndë ilustruese në fjalor.

### 3. Paraqitja terminologjiko-konceptore (e termave njëfjalësh e togfjalësh) në fjalorët terminologjikë në të dyja gjuhët (shqip - greqisht)

Mbi bazën e strukturës kuptimore të fjalës mund të zbulohet struktura konceptore e termit si e veçuar mbi bazën e strukturës semantike të fjalës, ku çdo term si shënues i një koncepti mëvetësohet sipas fushës së dijes, por secila strukturë mund të plotësohet më tej me zbërthime të tjera, ku konceptet dalin si “zhvillime” të njëri-tjetrit. Struktura konceptore del kështu me shkallë largësie të ndryshme ndërmjet koncepteve, të cilat (shkallët) mund të indeksohen numerikisht. Po sjellim një shembull me *kokë* si term, si përfaqësues për fusha të ndryshme, por edhe për koncepte të identifikuara në lidhjet sintagmatike të termit, që shërbejnë si kontekste të tilla.

| Shqip                                                                                                              | - | Greqisht                                                   |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---|------------------------------------------------------------|
| <i>kokë</i> 1 (mjek.) <i>kokë</i> (njeriu)                                                                         |   | (gr. <sup>9</sup> ) κεφάλι 1 (mjek.)<br>το κεφάλι (άντρας) |
| ↓                                                                                                                  |   | ↓                                                          |
| <i>kokë</i> 2 (mjek.) <i>kokë</i> (organi) (e ndërtuar,<br>mbi bazën e konceptit të<br>shprehur nga <i>kokë</i> 1) |   | (gr.) κεφάλι (όργανο)                                      |
| ↓                                                                                                                  |   | ↓                                                          |
| ↓                                                                                                                  |   | ↓                                                          |
| <i>kokë</i> 3 (bot.) ( <i>kokë</i> e pistilit)                                                                     |   | (gr.) (κεφαλή πιστολι)                                     |
| ↓                                                                                                                  |   | ↓                                                          |
| <i>kokë</i> 4.1 (mek.) ( <i>kokë</i> buloni)                                                                       |   | (gr.) (κεφαλή μπουλονιού)                                  |
| ↓                                                                                                                  |   | ↓                                                          |
| <i>kokë</i> 4.2 (mek.) ( <i>kokë</i> prerëse)                                                                      |   | (gr.) (κεφαλή κοπής)                                       |
| ↓                                                                                                                  |   | ↓                                                          |
| <i>kokë</i> 5 (mek.) <i>kokë</i><br>(blloku i motorrit)                                                            |   | (gr.) κεφαλή<br>(μπλοκ κινητήρα)                           |
| ↓                                                                                                                  |   | ↓                                                          |
| <i>kokë</i> 6 etj.                                                                                                 |   | το κεφάλι...                                               |

9 N.Gjini, *Fjalor greqisht - shqip*, Janinë, 1993.

Megjithatë vështroar nga pikëpamja terminologjike. d.m.th., nëse të tëra këto lidhje di t'i shihnim si shenja termformuese në kuadrin e tërë sistemit terminologjik, atëherë secila shenjë do të ishte bazë e ndërtimit të termave togfjalësh dhe gjithë struktura mund të shihej si strukturë homonimike<sup>10</sup>. Kjo mund të dilte e qartë nëse do t'i shihnim këto lidhje shkurt edhe në kuadrin e 2-3 fushave të dijes. Si shembull këtu mund të sillnim termin pikë, të përdorur në disa fusha dije si term më vete dhe në përbërje të termave togfjalësh, si elemente përcaktuese.

### Shqip

pikë (geom.)



pikë prerjeje - pikë ndërprerjeje -  
pikë rakordimi



pikë (usht.)



pikë zjarri - pikë vrojtimi  
pikë kontrolli



pikë (fiz.)



pikë ngrirjeje - pikë shkrirjeje  
pikë vlimi;



pikë etj.

-

### Greqisht

το σημείο (geom.)



σημείο τομής - σημείο διακοπής -  
σημείο συμφιλίωσης



το σημείο (usht.)



σημείο πυρκαγιάς - σημείο παρατήρησης  
σημείο ελέγχου



το σημείο (fiz.)



σημείο πήξης - σημείο τήξης  
σημείο βρασμού;



το σημείο...

Pra, kemi:

pikë: pikë (fjalë) - pikë (term njëfjalësh) - pikë shkrirje (term togfjalësh), sikurse në greqishte: η σταγόνα (fjalë) - το σημείο (term njëfjalësh) - σημείο πήξης (term togfjalësh).

Si përfundim mund të theksohet se ballafaqimi i shqipes me një gjuhë të huaj në rastin tonë me greqishten, anasjelltas ushqen, nxit, si dhe çon përpara studimin shkencor të këtyre gjuhëve në dritën e njëra-tjetrës, duke nxjerrë në pah tiparet e përbashkëta e veçoritë dalluese të njëra-tjetrës, në rrafshin e formës dhe të përmbajtjes, çka shërben

10 Xh. Lloshi, *Rreth disa shfaqjeve të homonimisë në gjuhën shqipe*, në: "Studime për leksikun....", I, Tiranë, 1972.

në mënyrë të veçantë në punën për hartimin e fjalorëve dygjuhësh e shumëgjuhësh, joterminologjikë dhe terminologjikë, në procesin e mësimdhënies së gjuhës së huaj në shkollë, në hartimin e teksteve mësimore etj.

## BIBLIOGRAFIA

- Duro A., 2009, «Termi dhe fjala në gjuhën shqipe», Tiranë.  
 Fjalori i gjuhës shqipe, Tiranë, 1980.  
 Gjini N., 1993, «Fjalor greqisht - shqip», Janinë.  
 Gjini N., 1998, «Fjalor shqip-greqisht», Janinë.  
 Hornby A., 1959, 1961, 1962, *The Teaching of Structural Works and Sentences Patterns*, stage I, II, III, L.  
 Kostallari A., 1984, “*Gjuha letrare Kombëtare shqipe dhe epoka jonë*”, Sf., Nr.4, f.42.  
 Kurti S., 1991, “*Fjalor politeknik anglisht-shqip*”, Tiranë, 1991.  
 Kurti S., 1981, “*Fjalor politeknik rusisht - shqip*”, Tiranë.  
 Lafe E., Çepani A., 2004, «*Rreth pasqyrimin të fushave terminologjike në «Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe» në Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektive*», Tiranë.  
 Lloshi Xh., 1972, “*Rreth disa shfaqjeve të ndikimit të homonimisë në gjuhën shqipe*”, në “*Studime mbi leksikun...*”, Tiranë.  
 Th. Feka, *Vëzhgime mbi leksikun terminologjik në «Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe»*, «Studime filologjike», 1986/2.